



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Autoriteti i Konkurrencës  
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority  
Nr. i Prot./Br. Prot./Prot. No. 577/24-11/0  
Nr. i Fq./No. SL/No. Pq. 114  
Data/Datum/Date: 09.09.2024  
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA

**Republika e Kosovës**  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
**Autoriteti i Konkurrencës**  
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority

**Vendimi Nr.77/24**  
**Datë: 09.09.2024**

Duke u bazuar në nenet 11, 13, 15, 16, 17, 18, 26, 27 dhe neni 55 nën paragrafi 1.5, të Ligjit Nr. 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës 01/2023 Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Relevant, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës në mbledhjen e datës 09.09.2024, mori këtë;

## V E N D I M

**I. LEJOHET.** Përqendrimi lidhur me marrjen e kontrollit nga Proteini.si d.o.o (blerësi) mbi një pjesë të aseteve dhe marrëdhënieve juridike nga MSG Online GmbH (shitësi), i cili do të transferoj atë në ATOMBODY GmbH.

**II.** Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim, obligohet të paguaj taksën administrative prej 1,000.00 €, me shkronja (njëmijë euro), dhe Vendimin për Realizimin e Përqendrimit, në përputhje me nenin 55, paragrafi 1.5, të ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe neni 24 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 6,000.00 € me shkronja (gjashtë mijë Euro).

## Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës, me datë; 17.07.2024, ka pranuar kërkesën me Nr. Prot. 452/24-11/H, lidhur me Njoftimin e Përqendrimit nga Proteini.si d.o.o, i cili do të marrë kontrollin mbi një pjesë të aseteve dhe marrëdhënieve juridike, nga MSG Online GmbH.

## Procedurat e ndjekura:

1. Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë 07.08.2024
2. Njoftimit për realizimin e përqendrimit në web faqen e AKRK-së me datë 08.08.2024
3. Me datë 19 Qershor 2024, Palët kanë nënshkruar kontrate mbi shitblerjen e pasurive të palujtshme.

## **Baza Ligjore dhe akti i Përqendrimit:**

Sipas nenit 13, të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, përmbushet detyrimi për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:

1. Qarkullimi i kombinuar i palëve në tregun ndërkombëtarë e kalon shumën 20,000,000 Euro.
2. Qarkullimi i një pale në Përqendrim e kalon shumën 1,000,000 Euro.
3. Marrëveshja e nënshkruar me datë 19 Qershor 2024, Proteini.si d.o.o si blerës dhe MSG Online GmbH si shitës, të cilët kanë lidhur marrëveshjen e Blerjes së Pronës.

**Proteini.si.d.o.o** është një kompani sllovene aktive në tregun e prodhimit dhe shitjes së produkteve ushqimore, me fokus në suplementet sportive, si dhe produkte të tjera sportive Në territorin e së cilës ushtron aktivitete biznesi dhe produktet Proteini.si janë të disponueshme edhe në Ballkan. Proteini.si d.o.o krijoi një markë me të njëjtin emër të njohur për produkte cilësore ushqimore sportive dhe suplimente dietike me çmime të përballueshme. Përveç produkteve ushqimore oferta e aplikuesit përfshinë produktet të tjera të destinuara për sport, kryesisht veshje dhe pajisje për stërvitje. Proteini.si nuk është prezent në tregun e Republikës së Kosovës.

**MSG Online GmbH**, një kompani austriake e cila përfshinë ligjin marrëdhëniet e Shitësit (të drejtat e qerasë kontratat me klientët dhe furnitorët) aktivet e prekshme (përfshirë aktivet fikëse dhe inventarin), aktivet jo-materiale (markat tregtare dhe të drejtat e tjera të pronësisë intelektuale) dhe në lidhje me markat ATOMBODY, prezent në tregun e shitjes dhe produkteve ushqimore sportive, veshjeve dhe pajisjeve për stërvitje në territoret e Austrisë dhe Gjermanisë.

MSG Online GmbH prona e specifikuar target do të transferohet kompanisë për qëllime të veçanta ATOMBODY GmbH, 100% e aksioneve do të blihen nga Aplikuesi, d.m.th. Proteini.si.

**ATOMBODY GmbH**- është e regjistruar në Vjenë të Austrisë, është pronare indirekte e MSG Online GmbH. Shoqëria ATOMBODY GmbH është themeluar ekskluzivisht për nevoja të transaksionit dhe si e tillë që nga themelimi i saj nuk ka ushtruar veprimtari afariste, d.m.th. nuk ka hyrë në marrëdhënie kontraktuale tregtare dhe as nuk përbën të drejtën dhe detyrime në marrëdhënie me të tretët, dhe nuk ka filiale nën pronësinë e saj. Gama e markës ATOMBODY përfshin produktet proteinike, suplemente sportive, produkte diete, veshje sportive, pajisjeve sportive dhe aksesore,, Prona e synuar nuk është e pranueshme në territorin e Republikës së Kosovës.

## **Struktura e Përqendrimit**

Më 19 Qershor 2024, Proteini.si si blerës dhe MSG Online GmbH si shitës kanë lidhur Marrëveshjen e Blerjes së Pronës, e cila i referohet një pjese të biznesit të shitësit (

“Marrëveshja e blerjes se pronës”). Te njëjtën ditë, me 19 Qershor 2024, është lidhur marrëveshja për blerjen dhe shitjen e aksioneve ndërmjet parashtruesit si blerës dhe z.Adrian Riklin si shitës i kompanisë për qëllime të veçanta ATOMBODY GmbH (“Marrëveshja e Blerjes se Aksioneve “). Qëllimi i Marrëveshjes së Blerjes së Aksioneve është transferimi i 100% të aksioneve në ATOMBODY GmbH tek Aplikuesi. Kjo kompani për qëllime të veçanta është krijuar vetëm për qëllimin e zbatimit të transaksionit dhe për qëllimin e transferimit të asetit të synuar në SPV pas mbylljes së Transaksionit.

### **Tregu përkatës:**

**Tregu i produktit** duke pas parasysh që përqendrimi kryhet jashtë territorit të Kosovës, d.m.th se aset i synuar do të jete aktiv jashtë territorit të Kosovës dhe se nuk do të ketë mbivendosje të aktiviteteve të pjesëmarrësve në përqendrim në tregun e Kosovës, si dhe aset i synuar nuk do të gjeneroj të ardhura në Republikën e Kosovës. Tregu përkatës i produktit mund të mbetet i hapur, dhe mund të përkufizohet si treg i shitjes së produkteve ushqimore sportive, veshjeve dhe pajisjeve sportive.

**Tregu gjeografik**, Tregu përkatës gjeografik, sipas udhëzimit Administrativ Nr.01/2023, tregu gjeografik do të thotë tregu që përfshinë zonën në të cilën ndërmarrjet përkatëse përfshihen në furnizimin dhe kërkesën e mallrave ose shërbimeve, në të cilën kushtet e konkurrencës janë mjaftë homogjene dhe mund të dallohen nga kushtet në zonat fqinjë në transaksionin e propozuar përkufizohet, si treg kombëtar.

### **Analiza e konkurrencës**

Transaksioni zbatohet dhe ka efekte jashtë territorit të Kosovës dhe pjesëmarrësit në përqendrim nuk janë aktivë në tregun përkatës të Kosovës, si para ashtu edhe pas zbatimit të Përqendrimit të planifikuar. Prandaj transaksioni nuk mund të çojë në probleme apo të kufizojë konkurrencën në tregun përkatës të Kosovës, pasi që as aplikuesi e as aset i synuar nuk janë të pranishëm në këtë treg. Prandaj, transaksioni në fjale nuk kontestohet nga këndvështrimi i rregulloreve për mbrojtjen e konkurrencës. Transaksioni nuk çon në krijimin apo forcimin e një pozicioni dominues në ndonjë treg përkatës, as nuk dëmton, kufizon apo parandalon konkurrencën në tregun e Republikës së Kosovës.

**Shënim:**

Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti-konkurrese, do të jetë, nën monitorimin e Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës.

Kërkesa për Përqendrim, merr epilogun si në dispozitiv të këtij VENDIMI.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**AUTORITETI I KONKURRENCËS  
KOMISIONI**



Kaltrina Sela  
Nënkryetare

Nafije Osdautaj  
Anëtare

Florent Mehmeti  
Anëtar

Salihe Gashi Loku  
Anëtare

III. Me këtë Vendim, të njoftohen:

- Palët
- Arkiva